

Të lexuarit e suksesshëm

1. Nxënësi lexues i suksesshëm.
2. Roli i mësuesit gjatë leximit

Për zhvillim gjuhësor të fëmijëve 8, 9 dhe 10 vjeç të lexuarit është një process që i ndihmon ato në secilën etapë. Çfarë duhet të jetë i aftë nxënësi të arrijë përmes të lexuarit?

Nxënësi duhet:

- Ta konsiderojnë veten si lexues.
- Të lexëjnë zhanre të ndryshme.
- Të mos ketë frikë se bëjnë gabime.
- Të rrisin rrjedhshmërinë dhe aftësinë për të lexuar tekstin në mënyrë të pavarur.
- Të ritregojë tregimet e lexuara.
- Të lexojë për të kuptuar pjesën.
- Të shkëmbejë mendime për atë që lexojnë me të tjerët.
- Të kuptojnë elementët bazë letrarë.

Kur mund ta konsiderojmë një nxënës lexues të mirë? A është lexues i mirë vetëm se njih mirë gjuhën? Si lidhet procesi i të lexuarit me të kuptuarit?

Sipas studiuesve:

- **Lexuesit e mirë janë lexues aktivë.** Kjo do të thotë se nxënësit janë të përqendruar dhe ndërveprojnë me tekstin, janë të vëmendshëm, të motivuar dhe të interesuar për tekstin. Nxënësi arrin të ndërveprojë me tekstin.
- **Lexuesit e mirë kanë qëllime të qarta se përse lexojnë.** Ata lexojnë për të marrë informacione, që përbën edhe funksionin kryesor të komunikimit. Ata lexojnë për të qartësuar çështje mbi të cilat kanë pikëpyetje, por edhe për t'u zbavitur.
- **Lexuesi i mirë arrin të përzgjedhës.** Nxënësit arrijnë të përzgjedhin informacionin për të cilin kanë interes. Pikërisht aty ata ndalojnë dhe përqendrohen më shumë.
- **Lexuesi i mirë lexon me perspektivë.** Gjatë procesit të të lexuarit, lexuesit e suksesshëm vazhdimisht parashikojnë se çfarë do ndodhë në vijim. Ata

mendojnë, hamendësojnë, verifikojnë nëse hamendësimet e tyre përputhen ose kundërshtojnë njëra-tjetrën.

- **Lexuesit e suksesshëm rishikojnë** dhe ngrenë pyetje mbi të kuptuarin ndërsa lexojnë. Ata përpiqen të nxjerrin domethënien e fjalëve të panjohura dhe koncepteve dhe të zgjidhin mospërputhjet apo mendimet jo të drejtpërdrejta sipas rasteve.
- **Lexuesit e mirë** krahasojnë, nxjerrin konkluzione dhe integrojnë njohuritë e tyre paraprake me materialin e tekstit.
- **Lexuesit e suksesshëm i lexojnë llojet e ndryshme të teksteve në mënyra të ndryshme:** kur lexojnë tekste narrative, lexuesit e mirë ndjekin me vëmendje ngjarjet dhe personazhet; kur lexojnë teste informuese, ata në mënyrë të vazhdueshme lidhin dhe bëjnë përmbledhjen e njohurive të marra.
- **Lexuesit e suksesshëm arrin të refletojë** mbi paragrafët e lexuar, para fillimit të leximit të tekstit, madje edhe pasi leximi ka përfunduar.

Disa hapa që ndihmojnë në monitorimin e të kuptuarit, përkatësisht sipas studiuesve janë:

1. identifikimi i vështirësisë; (koncepte të panjohura, njohuri paraprake të pamjaftueshme);
2. gjetja e përgjigjes duke e rilexuar paragrafin;
3. perifrazimi, rishikimi i ideve, qartësimi i koncepteve;
4. gjetja e përgjigjes më vijim të të lexuarit.

Çfarë kërkohet nga ana gjuhësore për të realizur të kuptuarit?

Theksi vendoset zakonisht në katër elemente gjuhësore bazë, për zhvillimin e të kuptuarit: *njohuritë fonetike, vetëdijen fonologjike, rrjedhshmërinë dhe fjalorin.*

- **Vetëdija e konsoliduar fonike** nënkupton: dallimin e fjalëve që fillojnë me të njëjtin tingull; veçimin dhe shqiptimin e tingullit të parë ose të fundit të një fjale; kombinimin dhe bashkimin e tingujve të shpërndarë në një fjalë të vetme; ndarjen e fjalëve në tinguj të veçantë.
- **Vetëdija e konsoliduar fonetike nënkupton:** identifikimin e fonemave; kategorizimin e fonemave; kombinimin e fonemave për të krijuar fjalë; ndarjen e fjalëve në fonema; heqjen ose shtimin e fonemave për të krijuar fjalë të reja; zëvendësimin e fonemave për të krijuar fjalë të reja.

Konsolidimi i vetëdijes fonologjike nënkupton:

- identifikimin dhe krijimin e rimave;
- dallimin e rrokjeve dhe ndarjes në rrokje të fjalëve;
- dallimin e shkronjës së parë të fjalëve;
- dallimin e fonemave të veçanta në fjalë të ndryshme.

Nxënësit duhet të kenë arritur rrjedhshmërinë në të lexuar, çfarë nënkupton leximin e tekstit shpejt dhe saktë, proces që ndikon në të kuptuarit e tekstit. Për më tepër, nxënësit duhet të kenë një fjalor të pasur të përbërë nga fjalë që mundësojnë komunikimin në mënyrë efektive.

Pse nxënësit mund të kenë vështirësi gjatë procesit të të lexuarit?

1. **U mungon përkrahja dhe inkurajimi.** Ata rriten në një mjedis ku leximi nuk vlerësohet sa duhet, ku nuk ka inkurajim të mjaftueshëm për të mësuar leximin apo nuk ka përkrahje aktive për përpjekjet e tyre dhe kanë qasje të kufizuar në materiale të leximit. Fëmijët që rriten në një mjedis të varfër leximi, kanë tendencë të lexojnë më pak dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e leximit më ngadalë se ata që rriten në një mjedis përkrahës dhe të pasur me materiale leximi.

2. **Mund të kenë vështirësi individuale.** Për shembull mund të kenë vështirësi me dëgjim-kuptimin, me njërin nga pesë elementët thelbësorë të leximit të cilët janë dhënë më lart (dhe që janë përshkruar më në detaje në pjesën 3 në vijim) apo me kombinim të dy apo më shumë komponentëve. Kjo situatë është shumë e zakonshme. Fëmijët mësojnë në mënyra shumë individuale dhe nuk përparojnë të gjithë në të njëjtën kohë. Pasi që leximi mësohet, e nuk fitohet, fëmijët kanë nevojë që leximi t'u mësohet; dhe mësimdhënia duhet të reflektojë nevojat e tyre individuale.

3. **Kanë ndonjë pengesë të natyrës së veçantë** Arsyeja e tretë, dhe më e rralla, është se mund të kenë ndonjë paaftësi të veçantë. Disa nxënës hasin vështirësi në mësimin e leximit sepse mund të jenë disleksikë ose mund të kenë probleme me shikim apo dëgjim. Nëse një fëmijë ka vështirësi në lexim mirëpo ka zhvillim konjitiv normal dhe nuk i përgjigjet planit përkrahës të individualizuar, atëherë mund të ketë ndonjë paaftësi të veçantë. Por fëmijët e tillë zakonisht janë në numër të vogël.

4. Mësimdhënësit e tyre nuk janë të vetëdijshëm për mënyrat më efektive të mësimdhënies së leximit. Fëmijët mund të hutohen dhe demotivohen nëse mësimdhënësit përdorin metoda të papërshtatshme

2. Roli i mësuesit për të përgatitur lexues të mirë.

Roli i mësuesit për të përgatitur lexues të mirë është edhe në këtë rast shumëdimensional. Ai ka një rol vendimtar sidomos në ciklin fillor. Si do t'i orientojë nxënësit një mësues i përgatitur? Aspektet kryesore do të shtriheshin në këto drejtime:

Rubrikat që do të përfshiheshin në aparatën pedagogjike gjatë orës së mësimi do të ishin:

- *Përse do ta lexojmë pjesën?*- nëpërmjet së cilës përcaktohet qëllimi i të lexuarit.
- *Çfarë dimë rreth temës?*- nëpërmjet të cilës aktivizojmë njohuritë paraprake.
- *A kemi pasur ne një eksperiencë të tillë?*- nëpërmjet së cilës lidhim eksperiencat e nxënësve me temën që do të trajtohet.
- *Mësojmë fjalët dhe shprehjet e reja* - nëpërmjet së cilës paraprakisht qartësohen fjalët dhe shprehjet e panjohura.
- *Çfarë do të ndodhë në tekst?* - nëpërmjet së cilës u kërkojmë nxënësve të parashikojnë.
- *Mësojmë si të mësojmë. Si të monitorojmë të kuptuarin? Si të përdorim strategji rregulluese* - nëpërmjet së cilës u mësojmë nxënësve strategjitë, duke i aplikuar në tekst.
- *Lexojmë tekstin* - nëpërmjet të cilës përpiqemi të realizojmë të kuptuarit.
- *I kthehem tekstit* - nëpërmjet së cilës monitorojmë të kuptuarin.
- *Lidhim paragrafët / përcaktojmë koherencën e ngjarjeve / përdorim hartën e mendimit/ diagramin e Venit* - nëpërmjet së cilës nxënësit praktikohen për të realizuar të kuptuarin.
- *I përgjigjemi pyetjeve rreth tekstit* - nëpërmjet të cilës matim nivelin e të kuptuarit të nxënësve.

- *Zbulojmë strukturën e tekstit* - nëpërmjet përdorimit të organizuesve grafikë qartësojmë subjektin dhe raportet ndërmjet personazheve dhe ngjarjeve.
- *Përmbledhim informacionin. Nxjerrim pikat e planit. Gjejmë idenë kryesore* - nëpërmjet të cilës zhvillojmë aftësitë sintetizuese të nxënësve dhe rrisim cilësinë e të kuptuarit të tekstit dhe forcojmë kujtesën afatgjatë.
- *Çfarë mendojmë ne për ngjarjet, apo farë mendojmë ne për informacionin?* - nëpërmjet të cilës nxisim diskutimet, zhvillojmë aftësitë e larta mendore dhe analitike të nxënësve.

E dimë se **motivimi** është shumë i rëndësishëm gjatë mësimit të leximit. Zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj të lexuarit është një nga gjërat më të rëndësishme. Fëmijët duhet të kënaqen duke lexuar dhe të ndjejnë kënaqësi gjatë mësimit nga leximi dhe diskutimit të asaj që kanë lexuar. Prandaj, mësuesi ka një rol parësor në procesin e motivimit.